

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7896  
E mërkurë, 2 tetor 2024  
Çmimi 0.50

Rutte merr udhëheqjen e NATO-s, zotohet për mbështetje të fuqishme për Ukrainën | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## MUHAMET MAVRAJ: URIME PËR DITËN E STUDENTËVE! URIME PËR 1 TETORIN! KJO E FUNDIT NUK ËSHTË RESPEKTUAR AQ. | FAQE 4-5

### AKTUALE



**LAJÇAKU PAS TAKIMEVE ME OSMANIN DHE KURTIN: DISKUTIMET DO TË NDIHMOJNË NË KRIJIMIN E ZGJIDHJEVE** F. 2

**I AKUZUARI PËR TENTIMVRASJE TË TRUMPIT DEKLAROHET I PAFAJSHËM** F. 6

**BISLIMI I PRET BURSISTËT E SKEMËS QË QEVERIA BASHKËFINANCOI ME BE-në** F. 7

### EKONOMI



**PYJET E KOSOVËS PËRBALLEN ME SHKATËRRIM TË PAKONTROLLUAR** F. 8

**MË 2 DHE 3 TETOR NË BERLIN, KOSOVA MERR PJESË NË FESTIVALIN GLOBAL TË GASTRONOMISË** F. 8

### SPORT



**SONTE NËNTË NDESHJET E TJERA NË LIGËN E KAMPIONËVE, VËMENDJA NË SFIDËN LEIPZIG - JUVENTUS** F. 10



Muhamet Mavraj, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, me rastin e kujtimit të protestës së 1 tetorit të vitit 1997, përvjetorit të 27, së bashku me një grup shokësh ka kujtuar këtë datë me nderime në varrezat e dëshmorëve të Llapit, aty

ku ka edhe studentë dëshmorë. Ai ka nderuar edhe dëshmorë të tjerë në komuna të tjera që kanë bërë shumë për Lëvizjen e Studentëve. Gjithashtu, Mavraj ka vizituar edhe personalitete që kanë qenë krahë studentëve në protesta. "Me neve

nuk ka filluar historia më 1 tetor 1997 dhe nuk ka mbaruar as me çlirimin dhe as me shpalljen e pavarësisë. Jemi gjithmonë në proces, gjeneratë pas gjeneratë", ka thënë Mavraj në shkrimet që ka publikuar në llogarinë e vet në "Facebook"

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# I akuzuari për tentimvrasje të Trumpit deklarohet i pafajshëm

WASHINGTON, 1 TETOR - Një burrë që, sipas autoriteteve, kaloi 12 orë jashtë fushës së golfit të ish-presidentit amerikan Donald Trump përpara se Shërbimi Sekret ta pikaste, u deklarua i pafajshëm ndaj akuzave federale, që përfshijnë akuzën për tentim vrasje.

I akuzuari Ryan Wesley Routh u paraqit në gjykatën federale në West Palm Beach disa ditë pasi u paraqit aktakuza me pesë pika, që lidhej me përpjekjen e dytë për të vrarë Trumpin që nga korriku.

Routh hyri në sallën e gjyqit i prangosur dhe i përshëndeti gazetarët e mbledhur për ta ndjekur procesin. Avokatët e tij refuzuan të komentojnë pas seancës.

Përpjekja e pretenduar për vrasje u pengua kur një anëtar i Shërbimit Sekret vuri re tytën e pushkës e Routh që dilte përtej gardhit të fushës së golfit, ku po

luante Trump, sipas autoriteteve. Një agjent qëllor në drejtim të Routhit, i cili u largua me shpejtësi dhe pastaj u arrestua pranë vendit të ngjarjes.

Zyrtarët kanë thënë se Routh nuk qëllor asnjë plumb dhe nuk e kishte Trump në rrezën e shikimit të tij. Ai la pas një kamerë digjitale, një çantë shpine, një pushkë dhe një qese plastike me ushqime.

Prokurorët kanë thënë se Routh kishte shkruar për planet e tij për ta vrarë Trumpin në një shënim të shkruar me dorë disa muaj para arrestimit të tij më 15 shtator, ku e përshkruante veprimin e tij si një "përpjekje të dështuar për vrasjen e Donald Trump" dhe ofronte 150.000 dollarë për këdo që mund ta "mbaronte punën".

Ky shënim ishte në një kuti që Routh raportohet se e kishte dorëzuar në shtëpinë e një dëshmitari të paidentifikuar disa



muaj para arrestimit të tij. Seanca e ardhshme në këtë rast do të mbikëqyren nga gjyqtarja federale Aileen Cannon, e cila u emërua në këtë post nga Trump dhe gjithashtu është caktuar të merrej me çështjen penale ku ish-presidenti akuzohet për mbajtjen e dokumenteve të klasifikuara në

pronën e tij në Mar-a-Lago. Cannon ka tërhequr vëmendje për mënyrën e saj të trajtimit të çështjes penale të Trumpit, të cilën e hodhi poshtë në korrik, vendim që tani po apelohej nga ekipi i këshilltarit special Jack Smith. Arrestimi i Routhit ndodhi dy muaj pasi Trump u qëllua dhe u plagos

në vesh gjatë një përpjekje për vrasje në një tubim fushate në Pensilvani. Shërbimi Sekret ka pranuar se ka pasur mangësi në sigurinë para atij sulmi, por ka thënë se masat e sigurisë funksionuan siç duhet për të parandaluar një sulm të mundshëm në Florida.

Fillimisht, Routh u akuzua vetëm për vepra penale që lidheshin me armët, përpara se prokurorët të ngrinin akuzat të tjera më serioze. Prokurorët shpesh ngrenë fillimisht akuzat më të lehta për t'u provuar dhe më pas shtojnë akuzat më të rënda gjatë zhvillimit të hetimit.

Akuzat e tjera përfshijnë posedimin e paligjshëm të armës, pavarësisht se ai kishte disa dënime penale, duke përfshirë dy akuzat për posedim të mallrave të vjedhura në vitin 2002 në Karolinën e Veriut. Ai gjithashtu akuzohet për posedimin e një arme me numrin serik të fshirë, në kundërshtim me ligjin federal.

## Zelensky thekson nevojën për përparime në fushëbetejë para takimit me aleatë

KIEV, 30 SHTATOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, pranoi edhe një herë situatën "shumë, shumë të vështirë" me të cilën po përballet ushtria ukrainase, pasi mbrojtjet ajrore u detyruan të shkatërronin valë të shumta dronësh rusë që synonin kryeqytetin Kiev.

Ndërkohë, homologu i tij rus, Vladimir Putin, përdori një festë shtetërore për të përsëritur angazhimin për t'i arritur objektivat e tij në Ukrainë.

Pas një takimi më 30 shtator me komandantët kryesorë, Zelensky deklaroi se "gjithçka që mund të bëhet këtë vjeshtë, gjithçka që mund të arrijmë, duhet të arrihet". Zelensky theksoi rëndësinë e takimit të ardhshëm të Kontratës së Mbrojtjes së Ukrainës në bazën ajrore amerikane Ramstein në Gjermani dhe nevojën për të bërë përparime para këtij takimi për të siguruar aleatët perëndimorë për aftësitë e Ukrainës në fushëbetejë. "Gjithçka varet nga secili anëtar i



ekipit ukrainas. Tani duhet të punojmë sa më shumë që t'i arrijmë para Ramsteinit", shtoi ai, duke iu referuar takimit të planifikuar për 12 tetor.

Në fushëbetejë, Serhiy Popko, kreu i administratës ushtarake në Kiev, tha se nuk pati dëme pasi

"valët" e dronëve sulmues u shkatërruan gjatë një alarmi pesë orësh ajror në qytet, që filloi rreth orës 1 të mëngjesit më 30 shtator. Ky ishte sulmi i dhjetë ajror rus mbi kryeqytetin ukrainas këtë muaj. Komandanti i administratës

ushtarake i rajonit të Kievit, Ruslan Kravchenko, tha më vonë se mbetjet e dronëve të shkatërruar ranë në gjashtë distrikte, por nuk shkaktuan viktima, por vetëm dëme të vogla. Autoritetet ushtarake ukrainase thanë se katër njerëz kanë vdekur dhe 37 të tjerë janë plagosur nga sulmet ajrore ruse gjatë 24 orëve të fundit në rajonet e Donjeckut, Hersonit, Harkivit, Dnipropetrovsk dhe Zaporizhjas. Ata thanë se Rusia lëshoi 73 dronë sulmues dhe tre raketa gjatë natës, dhe mbrojtja ajrore ukrainase rrezoi 67 nga dronët dhe një nga raketat.

Në Rusi, Putini u zotua të arrijë qëllimet e tij në Ukrainë në një mesazh më 30 shtator për përvjetorin e shpalljes së tij të njëanshme në 2022, që pretendonte aneksimin e katër rajoneve të Ukrainës pjesërisht të kontrolluara nga trupat ruse. Kombet e Bashkuara kanë miratuar disa rezoluta që

konfirmojnë integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës që nga pushtimi dhe aneksimi i Krimesë nga Rusia në 2014 dhe mbështetje për separatistët në Ukrainën lindore tetë vite përpara fillimit të pushtimit të shkallës së plotë në shkurt 2022. "E vërteta është në anën tonë", tha Putin në mesazhin e tij. "Të gjitha qëllimet e vendosura do të arrihen".

Qeveria ruse më 30 shtator njoftoi planet për të rritur shpenzimet për mbrojtjen me rreth 30 përqind për vitin 2025, pasi lufta e gjatë në Ukrainë - e parashikuar fillimisht nga Kremli si një pushtim i shpejtë dhe fitimtar - ka vazhduar për 31 muaj. Një draft buxheti tregoi se Rusia planifikon të rrisë shpenzimet e mbrojtjes vitin e ardhshëm në 13.5 trilionë rubla, duke drejtuar më shumë burime drejt luftës në Ukrainë edhe pse ekonomia e vendit vazhdon të përballet me sanksionet perëndimore.

## Koreja e Jugut shfaq raketën që mund t'i shkatërrojë bunkerët nëntokësorë të Veriut

SUEJ, 30 SHTATOR - Koreja e Jugut ka shfaqur raketën e saj më të fuqishme balistike dhe disa armë të tjera që synojnë Korenë e Veriut. Këto armë u shfaqën në ceremoninë e organizuar në Ditën e Forcave të Armatosura më 1 tetor, teksa presidenti jugkorean paralajmëroi regjimin e Veriut se do të kolapsojë nëse tenton të përdorë armë bërthamore.

Shfaqja e armëve të reja dhe paralajmërimi ndaj Koresë së Veriut erdhi pasi rivali verior i Seulit së fundi ka rritur armiqësitë rajonale, duke zbuluar një ndërtesë për pasurimin e uraniumit dhe ka testuar raketa para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale amerikane në nëntor. "Nëse Koreja e Veriut tenton të përdorë armë bërthamore do të përballet

me një përgjigje të fuqishme nga ushtria jonë dhe nga aleanca mes Koresë së Jugut dhe ShBA-së", tha presidenti Yoon Suk Yeol para mijëra trupave që u mblodhën në një aeroport ushtarak pranë Seulit. "Ajo ditë do të jetë fundi i regjimit të Koresë së Veriut". "Regjimi i Koresë së Veriut duhet të heqë dorë nga iluzioni se armët bërthamore do t'i mbrojnë", tha Yoon.





# Rutte merr udhëheqjen e NATO-s, zotohet për mbështetje të fuqishme për Ukrainën

**BRUKSEL, 1 TETOR** - Ish-kryeministri holandez Mark Rutte, menjëherë pasi mori udhëheqjen e NATO-s më 1 tetor, u zotua për mbështetje të fuqishme për Ukrainën.

Marrja e detyrës së sekretarit të Përgjithshëm nga Rutte ndodhi në një moment historik për aleancën, teksa pushtimi rus i Ukrainës po i afrohet ditës 1 000.

Rutte, kryeministri më jetëgjatë në historinë e Holandës, u takua me shefin në largim të aleancës, Jens Stoltenberg, në selinë e NATO-s në Bruksel, ku vendosën kurora lulesh për personelin e rënë të aleancës që përbëhet nga 32 anëtarë. Ata më pas shkuan në sallën ku mbahen mbledhjet e Këshillit të Veri Atlantikut.

Stoltenbergu u largua nga udhëheqja e aleancës pas një dekade. "Nuk mund të ketë siguri afatgjatë në Evropë pa një Ukrainë të fuqishme dhe të pavarur", tha Rutte në fjalimin e tij të parë nga zyra e re, teksa përsëriti zotimin e bërë nga udhëheqësit e aleancës më 2008 se "vendi i merituar i Ukrainës është në NATO". "Ne duhet të sigurohemi që Ukraina të triumfojë si një shtet sovran, i pavarur dhe demokratik", tha Rutte.

NATO-ja, e themeluar më 1949 për të penguar dhe mbrojtur nga çdo sulm nga anëtarët e saj në Evropën Perëndimore nga Bashkimi Sovjetik, e gjeti veten sërish në

qendër të vëmendjes për shkak të luftës së Ukrainës me Rusinë, që udhëhiqet nga presidenti autokrat Vladimir Putin.

Rutte duket se ka raporte të ngushta me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky.

Si kryeministër i Holandës ai ndihmoi që në Ukrainë të dërgoheshin avionët luftarakë F-16, siguroi sanksione më të ashpra ekonomike të Bashkimit Evropian ndaj Moskës, pavarësisht prej varësisë holandeze në tregti me Rusinë, dhe ndihmoi që Ukraina të lëvizte drejt anëtarësimit në BE. Por, politikani 57-vjeçar i lindur në Hagë, përballet me çështjen e ndërlikuar nëse duhet që Ukraina të marrë ftesë për t'iu bashkuar NATO-s.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve në Moskë se Putini e njuh mirë Rutten nga takimet e mëparshme dhe nuk pret ndryshime në politikë. "Pritjet tona janë që NATO-ja do ta vazhdojë punën në drejtimin e njëjtë", tha ai. "Në një pikë kishte shpresë për mundësinë e ndërtimit të raporteve të mira pragmatike - të paktën, kishte një dialog për këtë - por, më pas ne e dimë që Holanda mori një pozicion për përjashtimin e çdo kontakti me shtetin tonë", shtoi ai. Rutte e mori drejtimin e NATO-s vetëm një muaj para se Shtetet e Bashkuara, burimi kyç i financimit



të aleancës, t'i mbajë zgjedhjet presidenciale midis nënpresidentes demokrate Kamala Harris dhe ish-presidentit republikan Donald Trump. Ish-presidenti ka qenë kritik i NATO-s dhe nuk ka treguar nëse dëshiron që Kievi të dalë fitues në zmbropsjen e pushtimit të nisur

nga Kremli. Harris, ndërkaq, ka mbështetur vazhdimin e dërgimit të armëve në mënyrë që Ukraina të mund të luftojë. "I njoh të dy kandidatët shumë mirë... Do të jem në gjendje të punoj me të dy", tha ai. "Kam punuar për katër vjet me Trumpin. Ai ishte që na shtyu që të shpenzonim më shumë në

mbrojtje dhe ai e arriti këtë sepse ne tani kemi nivele më të larta të shpenzimeve sesa kishim para se ai të bëhej presidentin", shtoi Rutte.

Ai tha se Harris ka një "karrierë fantastike" si nënpresidente dhe është "një udhëheqëse shumë e respektuar".

## ShBA-ja dhe BE-ja i bëjnë thirrje për dialog spektrit politik në Shqipëri

**TIRANË, 1 TETOR** - Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë shprehur shqetësim dhe keqardhje për skenat që u panë një ditë më parë në Kuvendin e Shqipërisë dhe u bënë thirrje pushtetit dhe opozitës që të zhvillojnë dialog.

Deputetët opozitarë, gjatë seancës plenare të 30 shtatorit, nxorën jashtë sallës karriget e tyre dhe i dogjën para ndërtesës së Kuvendit. "Ambasada e ShBA-së është thellësisht e shqetësuar për shkatërrimin dhe forcën e shpalosur në Parlamentin shqiptar të hënën. Akte të tilla dëmtojnë dhe potencialisht lënduesen nuk kanë vend në procesin demokratik", u tha në reagimin e Ambasadës së ShBA-së në Tiranë.

Ndërkaq, më herët ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Silvio Gonzato, shprehu keqardhje për atë që ndodhi në Kuvendin shqiptar. "Në një demokraci funksionale si Shqipëria, pakënaqësi nga më të ndryshmet duhet të shprehen në mënyrën e duhur dhe nuk duhet që të përdoret dhunë apo të bëhen dëmtime ndaj pronës për të shprehur mendimin. Sepse deputetët e Kuvendit të Shqipërisë duhet të kenë mundësinë që të



përbushin dhe të luajnë rolin e tyre në siguri të plotë", tha Gonzato. Duke kujtuar se Shqipëria ndodhet para një momenti të rëndësishëm, siç është vendimi për hapjen e negociatave me BE-në, ambasadori Gonzato tha se ky zhvillim pozitiv për Tiranën kërkon bashkëpunim mes pushtetit dhe opozitës.

Ai theksoi se është shumë e rëndësishme që Kuvendi të luajë rolin e duhur që Shqipëria të bëhet një vend anëtar në një demokraci

funksionale, pasi kjo ka të bëjë me objektivin madhor që ka Shqipëria që të jetë në bllokun evropian. "Thirrja që unë u bëj të gjithëve në këtë moment është t'i ktheheni dialogut, jo që të bini dakord për gjithçka, por për të diskutuar dhe dialoguar. Gjithashtu të shmangen sulmet personale apo verbale. Lutem që të ulet përshkallëzimi", tha Gonzato pasi mori pjesë në punimet e Asamblesë parlamentare të Nismës për Evropën Qendrore, presidencën e

së cilës Shqipëria e mban prej 1 korrikut.

Thirrje për dialog bëri edhe Ambasada e ShBA në Tiranë. "Nxitim të gjitha palët e përfshira të ushtrojnë vetëpërmbytje, të angazhohen në dialog konstruktiv si dhe të përqafojnë vlerat e respektit dhe qytetarisë. Mbështesim diskutimet paqësore dhe bashkëpunuese lidhur me negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në BE si dhe do të vazhdojmë të qëndrojmë krah

institucioneve shqiptare, teksa punojnë për ta sjellë Shqipërinë më pranë bashkësisë euroatlantike", tha Ambasada amerikane.

Më 30 shtator, deputetët e Partisë Demokratike nxorën jashtë sallës së Kuvendit karriget e tyre dhe u vunë zjarrin në shenjë proteste ndaj burgosjes së deputetit Ervin Salianji. Ata po ashtu kërkuan një Qeveri teknike, që pas tyre, do ta çonte vendin në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Ndërkaq, Partia Socialiste në pushtet dorëzoi në Kuvend kërkesën për marrjen e masave disiplinore ndaj 24 deputetëve të opozitës, që u bënë pjesë e djegies së karrigëve dhe skenave të tjera të dhunshme në sallën e Kuvendit.

Policia e Tiranës ka referuar në Prokurorinë e Posaçme deputetët e opozitës që u bënë pjesë e këtij veprimi. "Këta shtetas kanë kryer veprime të dhunshme duke dëmtuar foltoren e Kuvendit, kanë thyer një karrige dhe kanë hedhur në drejtim të kryetares së Kuvendit dhe anëtarëve të kabinetit qeveritar sende të forta [pjesë të karrigës së thyer]. Gjithashtu kanë djegur disa karrige në ambientet e jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", u tha në njoftimin e Policisë së Tiranës.





# Muhamet Mavraj: Urime për Ditën e Studentëve! Urime për 1 Tetorin! Kjo e fundit nuk është respektuar aq

Muhamet Mavraj, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, me rastin e kujtimit të protestës së 1 tetorit të vitit 1997, përvjetorit të 27, së bashku me një grup shokësh ka kujtuar këtë datë me nderime në varrezat e dëshmorëve të Llapit, aty ku ka edhe studentë dëshmorë. Ai ka nderuar edhe dëshmorë të tjerë në komuna të tjera që kanë bërë shumë për Lëvizjen e Studentëve. Gjithashtu, Mavraj ka vizituar edhe personalitete që kanë qenë krahë studentëve në protesta. "Me neve nuk ka filluar historia më 1 tetor 1997 dhe nuk ka mbaruar as me çlirimin dhe as me shpalljen e pavarësisë. Jemi gjithmonë në proces, gjeneratë pas gjenerate", ka thënë Mavraj në shkrimet që ka publikuar në llogarinë e vet në "Facebook"

Urime për Ditën e Studentëve! Urime për 1 Tetorin!

**EPOKA ERE** Nga Muhamet MAVRAJ

Me neve nuk ka filluar historia më 1 tetor 1997 dhe nuk ka mbaruar as me çlirimin dhe as me shpalljen e pavarësisë. Jemi gjithmonë në proces, gjeneratë pas gjenerate. Pas çlirimit, si shenja të Lëvizjes Studentore në Prishtinë i kemi lënë tri sosh: Një

rugë me emrin 1 Tetori, sallën e sporteve me emrin "1 tetori '97" dhe Ditën e Studentëve për çdo 1 tetor.

Kjo e fundit nuk është respektuar aq, veçse si përvjetor aty-këtu. Pas vdekjes së rektorit Statovci e kemi lënë një pllakë në shtëpinë e atëhershme të rektoratit në Velani me fytyrën e dallueshme të rektorit dhe katër siluetave të

liderëve studentorë. Nuk e di çfarë ka ndodhur por, pas renovimit të shtëpisë, më nuk qenka këtu.

Por, prej sot kthehet zyrtarisht Dita e Studentëve dhe jam i kenaqur me këtë, me kusht që të bëhet për të gjitha universitetet tona.

Nuk di kënd ta vizitoj apo uroj më përpara sot. Nuk kam aq

zemër sa ta rrapëlloj arkivin e fotografive dhe dokumenteve 1997-'99 që të krijohet një agjendë, sepse do t'i përfshinte që të gjithë e që të gjitha: qindra fotografi me studentët më të mirë e qindra me studentet më të angazhuara në mundësitë e tyre, në demonstrata, në gazetari, në luftë; dhe, dhjetëra e dhjetëra profesorë e profesoresha, plot përkrahës në prapavijë, qindra studentë që u bënë edhe ushtarët e ushtaret më të mirë, plot prej tyre edhe dëshmorë. Fare pak mund të bëj për pak orë, mbase do t'i shoh sadopak disa nga më pak të përmendurit sa i përket të paktën 1 tetorit, angazhimet e heshtura të tyre, para e pas 1 tetorit. Nëpërmjet tyre do të doja që të ndihen të vizituar e të nderuar që të gjithë. Dhe që të gjithëve ju uroj sot nga thellësia e zemrës 1 tetorin dhe

gjithçka të mirë në jetë, kudo që të jeni, mbi të gjitha shëndet për ju e fëmijët që janë lumturia e Kosovës, por, amanet, me përlulje: vetëm në Kosovë!

Urime të gjithë studentëve të atëhershëm e të sotëm!

Ecim përpara!

Do të vijmë ndryshimet për Kosovën gjithmonë, por kësaj radhe ndryshime jo nga improvizuesit e atdhedashurisë. Nuk ecet tutje duke shkelur vlerat që sollën të pamundurën e dikurshme: lirinë!

**1 tetori fillon me nderime në varrezat e dëshmorëve të Llapit**

Kësaj radhe me gjithë zemër 1 tetorin e filluam me nderime në varrezat e dëshmorëve të Llapit ku ka edhe studentë dëshmorë.



Ky vend, në Penuhe, të lehtëson shpirtërisht sapo ta kalosh traun e varrezave, me rregullin e pashoq, një projekt madhështor, model për trevat e tjera. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

### Te varri i Hakif Zejnullahut

Vetëm katër ditë pas rënies së këtij burrit këtu, Hakif Zejnullahut (që ra me Zahirin e Edmondin më 31 janar 1997) morëm nën drejtim organizatën studentore, më 4 shkurt 1997, ndërkohë që përgjatë dy javëve para rënies së tyre, e tërë prapashpina jonë ose ishte arrestuar ose ishte arratisur nga Kosova, me fare pak djelmosha të kthyer në mal. Ende e kam peng takimin që kurrë nuk u bë. Vazhduam në atë atmosferë tepër të rëndë, aq sa mbetëm këtu atëherë. Ata nuk ranë kot aq herët! Afër e ka pararendësin trim, Hasan Ramadanin, më tutje pasrendësin Hyzri Tallen. Të tjerët janë thjesht ushtarët e tyre dëshmorë. Dhe, s'ka bota gradë më të lartë! Nderime pa kufi!

### Nuk të harrojmë Bedri Bajrami - Bedi!

Nuk është hera e parë që e vizitov vendprehjen e dëshmorit Bedri Bajrami - Bedi, por po të mundja do ta vizitova çdo ditë. Si student i Edukatës Fizike ka bërë shumë për Lëvizjen e Studentëve, gjithmonë thujse bashkë me Remin. Më shumë se shpirtin nuk pati çka t'i japë lirisë së kombit.

Këtë njeri dhe shokun e rrallë Nazmi Muzliqajn pak kohë para tij, pas takimeve të fundit, i kam shikuar derisa u zhdukën nga pamja në kthesat e para. Atdhetarë hakikat! Më ka tejshpuar lajmi për rënien. S'doja ta besoja, por Remi e konfirmoi me këtë përgjigje: "Ma thau krahun"! Lavdi e përjetshme!

### Te baca Jusuf Gashi në Drenoc të Rahovecit, ishte në krah të studentëve

Te baca Jusuf Gashi në Drenoc të Rahovecit, fshat-kazermë, plot lavdi e dëshmorë, edhe studentë. Kujtesën brisk, për demonstrata e

për luftë, edhe më 1 tetor 1997, plot entuziazëm në krah të studentëve. I ri gjithmonë dhe me plis gjithmonë. Pafund tregime pa të cilat zor të ilustron lavdia e kësaj ane, shtyllë edhe për Shtabin e Përgjithshëm. "Kemi luftu për shtet e jo për pushtet", e tha sa herë. Na uroi një mijë herë për 1 tetorin. E falënderuam deri në qiell për krejt çfarë ka bërë për Kosovën. Nderime për plagët e trupit të tij që nuk i përmend vetë!

### Nuk të harrojmë Feim Gashi!

Lideri studentor i Fakultetit të Bujqësisë, Feim Gashi, prehet këtu në Drenoc të Rahovecit, dëshmor, krahas vëllait dëshmor, Bedrushit. Ra me liderin tjetër studentor të Prizrenit, në të njëjtën makinë, Përparim Thaçin.

I takon modelit të studentëve thellësisht të angazhuar të cilëve nuk ua kujtoj mirë ngjyrën e zërit. Sikur Bedi, aq pak fliste, aq i butë, aq i lehtë e praktik, në çdo ngjarje, jo përcjellës i tyre, por mu në vllug dhe kreator i tyre. Nuk është e paharrueshme me të vetëm protesta e parë më 1 tetor 1997, por edhe ajo e fundit më 30 prill 1998 kur u brohorit për të parën herë qartas për UÇK-në në Prishtinë (më herët brohoritej për Drenicën). Bashkë me një grup shokësh erdhëm edhe këtu për nderime. E falënderojmë fort për respektin familjen e tij patriotike, të gjithë vëllezërit e nipat dhe bashkëluftëtarët e tjerë. Kjo familje dha kaq shumë për lirinë që nuk po e çmojmë sa do të donin këta dëshmorë! Lavdi e përjetshme Feim Gashit, Përparimit, Bedrushit, Mensur Zyberajt dhe të gjithë dëshmorëve.

### Në përvjetorin e 27, takim me familjarët e Calit

Calin (Sali Mustafën) nuk munda ta takoj në Hagë kur isha për jubileun 25, sepse atëherë ishte në ndalesa. Një pjesë e pengut m'u hoq sot duke takuar familjarët e tij për këtë 1 tetor. Siç kam treguar më moti, Cali nga çatia e shtëpisë së tij i vëzhgonte satrapet që vëzhgonin rreth shtëpisës ku banoja. I njihte



sepse e kishin torturuar po ata. Por, ky nuk është kujdesi i tij i vetëm para dhe pas 1 tetorit 1997.

Djali i Calit më befasoi me qëndrimin dinjitoz dhe pjekurinë, futbollist i "Prishtinës" dhe student i mjekësisë, sikur motra Buna, studente e shkëlqyeshme e mjekësisë. Ata e dinë se libri i lirisë ka shumë fleta të tjera të pambushura, tërë jetën tonë, sepse mbrojtja e lirisë nuk është më pak e vlefshme sesa fitorja e lirisë. Gjyqtarët në Hagë nuk e dënuan Calin, por vetveten. Ka gjyq mbi gjyq. E vërteta është veç një. Këtë duhet ta mbajnë në mendje të gjithë përfituesit e burgosjeve të çlirimtarëve të Kosovës.

### Dhjetëra e qindra bashkëndihmues të pazhurmshëm kanë merita fundamentale, një nga ata është Nuhi Paçarizi

Njerëzit shohin vetëm datën e parë, jo çfarë e sollti atë dhe çfarë e përcolli në rrugën e gjatë të këtij vendi. Dhjetëra e qindra bashkëndihmues të pazhurmshëm kanë merita fundamentale. Një nga ata është Nuhi Paçarizi, gazetar i hershëm, guximtar i "Zërit të Kosovës",

veprues i viteve të vështira për të cilat po paguan një faturë serioze shëndetësore.

Së paku dy vjet para 1 tetorit 1997 ai dhe drejtuesit e Unikombit, Afrim Morina e Avdi Gjata, me bashkëpunëtorë, për mua ishin derë e hapur. (Ndër të tjera, me telefaksin e tyre i kemi shpërndarë letrat e para drejt Perëndimit. Ishim në zero.). Ata pa hezitim përkrahën ringritjen studentore 1997.

Nuhiu u emocionua pamatshëm

për 1 tetorin dhe ia uroj barabartë sa bashkëdrejtuesve të afërm të kohës. Kemi çfarë e çfarë të kujtojmë.

### Hyrie Veliu është një nga promotorët e padukshëm të 1 tetorit 1997

Kjo nuk duhej të vdiste patjetër për të qenë ashtu dhe vetëm ashtu e mirë. Rrethohemi nga njerëz të mrekullueshëm pa të







cilët do të na lëshonte toka. Hyrie Veliu është një nga ato dhe ata. Nuk do të kishim sukses kurrë pa heronjtë e heshtur, kudo rreth nesh. Hyra është një nga promotorët e padukshëm të 1 tetorit 1997, shumë kohë më përpara dhe deri

në çlirim, për të mos thënë veprimtare ende, deri më sot. U bë edhe një nga ushtaret më të famshme të lirisë, me emrin e luftës - Jeta. Ky emër u bë frymëzim për shumë prindër rinj si emër për vajzat e tyre. Dashti i lumi nalt dhe ia dha në



jetë edhe Hyrës një vajzë me po atë emër: Jeta! "My love, my princess, my sunshine, my everything", thotë e lumtur për të. Sot e kapërthurë jetën disi me fitimet e imëta sa në një kurs të

anglishtes sa në një tjetër. E shoh shpesh në vrap, të lodhur në dukje, por gjithmonë me respekt të thellë për jetën dinjitoze, pa u ankuar kurrë! Është trimëreshë e urtë! Dhe, gati përsëri po qe nevoja e atdheut. Faleminderit Hyrie për gjithçka që bërë për këtë vend dhe urime për 1 tetorin tënd! Mbi gjithçka, shëndet!

**Baca Ganë, gëzuar 1 tetorin!**

Ky njeri këtu nuk ka asgjë më pak merita sesa cilido veprimtar i viteve 1997-'99 në Universitet. I mbushi 80 të mira. Gani Ademi për gati 30 vjet ishte sekretar i gazetës "Bota e re", 1970-1999. Ka pritur e përcjellë të gjitha gjeneratat e gazetarëve dhe drejtuesve të "Botes së re", dhjetëra e qindra. (Demaku, Rugova, Kraja, Mala, Zogaj, Hamzaj etj.). Por, më 4 shkurt

1997, kur mora nën drejtim edhe "Botën e re" do të ndërrojë tërësisht gjithçka nga tempoja e jetës dhe jo vetëm për të. Ky e dinte se duhet të bëhet i ri edhe një herë: në periudhën 1997-'99 u zgjeruan angazhimet dhe rreziqet, tani me angazhime edhe për Unionin e Studentëve, paralelisht, në plot detyra. Makina e tij private ishte e vetmja për të gjitha nevojat tona, shofer, përcjellës, përgjegjësia financiare e zgjeruar si saç mbi kokë, punë pa orar, lëvizje sidomos me mua kohë e pa kohë, gati tërësisht natën, me telefon te koka në çdo sy gjumi. Rreziku i fillonte që në derë nga fqinjët e tjetrës etni. Fati e ruajti!

Nuk shkel më këmbë në Universitet për kompetencë, etikë, besnikëri e guxim zyrtari sa e Gani Ademit dhe prorektorit financiar Ahmet Geca. Sidomos kah paraja njihen karakteret e vërteta. Po të zgjaste lufta që të dy do të punonin për Shtabin e Përgjithshëm, sipas rekomandimit. Të dy ishin gati dhe me një mendje për t'u nisur, ndërkohë që dy burra me nam refuzuan me aq frikë të merrnin ndonjë detyrë atje lart. Nodhi Reçaku e më pas Rambujeja dhe krejt në fund bombardimet e ëndërruara me vite dhe ndryshuan planet e jetës për të gjithë.

Baca Ganë, gëzuar 1 tetorin! Rrofsh sa malet!





# Në përvjetorin e Lëvizjes Studentore të 1 Tetorit 1997 dhe bashkimin me UÇK-në për liri dhe pavarësi



Shkruan:  
Prof. Dr. Fejzulla  
BERISHA

Lëvizja studentore e 1 Tetorit 1997 është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Kosovës gjatë viteve 1990, dhe simbolizon fillimin e një rezistence më të organizuar dhe masive kundër regjimit serb në Kosovë. Kjo lëvizje u zhvillua në një periudhë kur regjimi i Sllobodan Millosheviqit kishte ashpërsuar masat e tij represive kundër shqiptarëve të Kosovës, duke përfshirë edhe përjashtimin e tyre nga sistemi arsimor dhe uzurpimin e institucioneve arsimore, përfshirë Universitetin e Prishtinës.

Shtypja serbe dhe izolimi i shqiptarëve: Pas shfuqizimit të autonomisë së Kosovës më 1989, nga ana e Millosheviqit, ndodhi një ndërhyrje e thellë në të gjitha institucionet publike në Kosovë, përfshirë edhe universitetet dhe shkollat. Shqiptarët u përjashtuan nga institucionet shtetërore dhe filloi një politikë e aparteidit arsimor dhe kulturor, ku studentët shqiptarë u dëbuan nga objektet e Universitetit të Prishtinës dhe të tjera shkolla. Mësimi për shqiptarët u bë në kushte të pamundshme, shpeshherë në shtëpi private ose ambiente të improvizuara. Në këto rrethana, popullsia shqiptare organizoi një rezistencë paqësore dhe paralelisht krijoi institucione të pavarura, të cilat përfshinin edhe arsimin e organizuar në formë të ashtuquajturit "sistem paralel". Në këtë kontekst, universiteti u bë simbol i asaj që shqiptarët po përpiqeshin të mbronin: kulturën e tyre, të drejtat e tyre themelore dhe identitetin kombëtar. Një brez i ri studentësh, që ndjeu padrejtësinë dhe izolimin, filloi të organizohej dhe të kërkonte rikthimin e mundësisë për të ndjekur studimet në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Organizimi i Lëvizjes Studentore: Lëvizja e 1 Tetorit 1997 ishte kulmi i përpjekjeve disa mujore të studentëve të Universitetit të

Prishtinës për të organizuar një protestë masive. Në krye të kësaj lëvizjeje qëndronte një grup i organizuar studentësh, të cilët arritën të mobilizojnë mijëra studentë dhe qytetarë të Kosovës. Këta udhëheqës studentorë bënë thirrje për protesta paqësore për lirin e objekteve universitare, duke synuar që mësimi të kthehej në kuadër të institucioneve të rregullta. Kërkesat kryesore të kësaj lëvizjeje ishin: Lirimi i objekteve universitare; Rikthimi i hapësirave të universitetit për përdorim nga studentët dhe stafi shqiptar. Barazi dhe të drejta arsimore: Një fund i diskriminimit dhe ndarja në baza

etnike në arsimin publik në Kosovë.

Liri e shprehjes dhe e veprimt politik: Një apel për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për të mbrojtur të drejtat themelore të shqiptarëve të Kosovës.

Protesta e 1 Tetorit 1997: Më 1 Tetor 1997, mijëra studentë dhe qytetarë të tjerë të Kosovës marshuan në rrugët e Prishtinës, duke mbajtur pankarta dhe duke kërkuar drejtësi. Protesta u përpoq të ishte paqësore, duke ndjekur frymën e rezistencës pasive që po udhëhiqej nga liderët politikë të kohës, si Ibrahim Rugova dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Megjithatë, regjimi serb nuk e toleroi këtë shfaqje të rezistencës dhe vendosi të përgjigjej me dhunë. Forcat policore dhe paraushtarake serbe u përleshën me protestuesit, duke përdorur gaz lotsjellës, shkopinj gome dhe metoda të tjera represive për të shpërndarë turmën. Qindra studentë u arrestuan, shumë prej tyre u plagosën, dhe dhuna e autoriteteve serbe u përhap shpejt në media, duke treguar ashpërsinë e regjimit kundër popullsisë shqiptare të Kosovës.

Rëndësia e Lëvizjes Studentore: Protesta e 1 Tetorit dhe lëvizja studentore më gjerë shërbyen si një

pikë kthese në lëvizjen për çlirimin e Kosovës. Kjo protestë tregoi qartë se brezi i ri i shqiptarëve të Kosovës nuk do të dorëzohej përballë represionit dhe se kishte vullnetin dhe vendosmërinë për të kërkuar të drejtat e tij. Kjo lëvizje u bë një frymëzim për organizime të tjera të ngjashme dhe luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e një fryme të përgjithshme të rezistencës paqësore në Kosovë. Në të njëjtën kohë, protesta e studentëve tërhoqi vëmendjen ndërkombëtare mbi situatën në Kosovë dhe dhunën e pashpjegueshme të regjimit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ajo kontribuoi në rritjen e presionit ndërkombëtar mbi regjimin e Millosheviqit dhe ndihmoi në forcimin e pozicionit të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare.

Ndikimi në Lëvizjen për lirinë e Kosovës: Pas 1 Tetorit 1997, rezistenca në Kosovë filloi të marrë një formë më të organizuar dhe të vendosur. Ndërsa lëvizja paqësore dhe rezistenca institucionale vazhdonin, në të njëjtën kohë filloi të rritet edhe ndikimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila përdori mjete të tjera për të luftuar për lirinë e vendit. Brezi i studentëve dhe të rinjve që morën pjesë në protestat e 1 Tetorit ishin po ata që më vonë do të bashkoheshin me UÇK-në për të luftuar kundër forcave serbe. Lëvizja studentore, e kombinuar me organizatat politike dhe ushtarake, luajti një rol të rëndësishëm në përshejtimin e përpjekjeve për pavarësinë e Kosovës. Me përshtatshëm dhe dhunës nga ana e Serbisë, ndërhyrja e NATO-s më 1999 dhe çlirimi përfundimtar i Kosovës, lëvizja e 1 Tetorit mbeti një pikë referimi e rëndësishme për qëndresën e shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për liri.

Trashëgimia e Lëvizjes Studentore sot: Lëvizja e 1 Tetorit kujtohet si një nga momentet më të rëndësishme të historisë së Kosovës moderne. Ajo është një dëshmi e forcës së popullit shqiptar, që përmes veprimeve paqësore dhe vendosmërinë kolektive, arriti të qëndrojë përballë një regjimi shtypës dhe diskriminues. Kjo lëvizje nuk ishte thjesht një përpjekje për lirinë e objekteve universitare, por një simbol i luftës së popullit shqiptar për liri, drejtësi dhe të drejta themelore, një rezistencë që kulmoi me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 2008.



## Edhe në Kosovë shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave të Moshuar

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Çdo vit më 1 tetor e gjithë bota shënon Ditën Ndërkombëtare të Personave të Moshuar, e cila ka qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për sfidat dhe mundësitë që paraqiten ndaj popullatës në plakje, duke mobilizuar familjet, grupet e komunitetit dhe palët e interesuara për t'i adresuar

vështirësitë me të cilat përballen të moshuarit.

Në këtë vit kjo ditë shënohet me moton "Përvoja dhe kontributi ynë ka vlerë: Ndërtojmë komunitete të forta, së bashku!" dhe thekson rëndësinë e rolit që luajnë të moshuarit në forcimin e shoqërisë sonë.

Është detyra jona si shoqëri të

krijojmë mundësi për të gjithë të moshuarit, duke e bërë kështu ambientin tonë më të përshtatshëm për ta. Aktivitetet që u organizuan për këtë ditë kishin për qëllim ta ndryshojnë narrativën mbi moshimin dhe ta nxisin dialogun për përmirësimin e kushteve të jetesës për të moshuarit.





## Lajçaku pas takimeve me Osmanin dhe Kurtin: Diskutimet do të ndihmojnë për krijimin e zgjidhjeve

PRISHTINË, 1 TETOR - Emisari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka bërë një përmbledhje të takimeve që ka zhvilluar në margjina të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju-Jork.

Lajçaku në "Facebook" ka theksuar pjesëmarrjen e tij në drekën tradicionale të liderëve të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga shefi i Diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, derisa ka përmendur diskutimet për Ballkanin Perëndimor.

Mes tyre ka ndarë edhe fotografi nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të shtetit të Republikës së Kosovës, me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Në fund ka shprehur besimin se diskutimet që kanë pasur do të ndihmojnë në krijimin e zgjidhjeve efektive për sfidat me të cilat përballemi globalisht. "Sapo u ktheva nga një javë intensive në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju-Jork! Unë pata mundësinë të përfshihesha në diskutime kuptimplota rreth multilateralizmit, ndërtimit të paqes dhe Ballkanit Perëndimor brenda dhe jashtë ndërtesës së OKB-së. Përveç bisedave me miqtë dhe partnerët, mora pjesë në drekën tradicionale të Ballkanit Perëndimor me liderët nga rajoni, organizuar nga HR/VP dhe fola në Samitin e Ndikimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të WEF-së", ka shkruar Lajçaku në "Facebook".



## Shqipëria dorëzon në UNESCO kërkesën për përfshirjen e lumit Vjosa në pasuritë natyrore botërore



TIRANË, 1 TETOR - Shqipëria dorëzoi të hënën pranë UNESCO-s kërkesën për përfshirjen e Parkut Kombëtar të lumit Vjosa në pasuritë natyrore botërore në programin "Njeriu dhe Biosfera". Aplikimi pritet të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, që mbahet vitin e ardhshëm.

Lumi Vjosa, i njohur si një nga lumenjtë e fundit të egër në Evropë, u shpall Park Kombëtar nga qeveria shqiptare në mars të vitit të kaluar pas përpjekjeve disavjeçare të organizatave shqiptare dhe ndërkombëtare mjedisore për mbrojtjen e këtij lumi nga ndërtimi i digave të hidrocentraleve.

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumabro, tha se dosja përmbante një punë të mirëkoordinuar të autoriteteve

shqiptare me ekspertët e UNESCO-s dhe Unionit Ndërkombëtar të Mbrojtjes së Natyrës e cila shkon paralelisht me miratimin e Planit të Integruar të Menaxhimit të Vizitorëve të Vjosës.

Lumi i Vjosës është ndër lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, sidomos sa iu përket prurjeve të shumta ujore.

Me një gjatësi prej 272 km, Vjosa rrjedh nga malet e Pindit në Greqi dhe përshkon territorin shqiptar deri në derdhjen në Adriatik.

Në pjesën fundore lumi Vjosa vijon të rrezikohet nga ndërtimet në funksion të turizmit masiv.

Rreth 40 studiues shqiptarë dhe të huaj të natyrës kërkuar nga qeveria shqiptare në prill të këtij viti që ta përfshijë Deltën e Lumit Vjosa në Parkun Kombëtar të Vjosës dhe ta ndalë vizionin për projekte të turizmit masiv.

## Bislimi i pret bursistët e skemës që qeveria bashkëfinancoi me BE-në, do të punojnë për së paku 3 vjet si nëpunës civilë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 1 tetor - Të martën u mbajt ceremonia e dhënies së akt-emërimeve për bursistët e raundit XIII nga Skema e Profesionistëve të Rinj (YCS), projekt i financuar me fondet e IPA të Bashkimit Evropian dhe i bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës, përzgjedhja e të cilëve është kryer përmes një procesi transparent dhe konkurrent, me synimin e tërheqjes së profesionistëve të rinj në administratën publike. Bursistët u mirëpritën nga zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, e ku e pranishme ishte dhe zëvendësambasadorja e

Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Eva Palatova.

Zëvendëskryeministri Bislimi u uroi mirëseardhje bursistëve në kuadër të shërbimit civil të Republikës së Kosovës dhe shtoi se qeveria vijon ta përkrahë këtë program, i cili sjell kuadro në administratën publike dhe ofron mundësi për të rinjtë dhe të rejtat, për rritjen e tyre profesionale dhe të përvojës. "Bursistët kanë kryer studimet themelore në fusha dhe sektorë të ndryshëm prioritarë për qeverinë, duke përfshirë drejtësinë, ekonominë, diplomacinë, administratën publike, mjedisin, energjinë dhe ndryshimet klimatike. Pas kryerjes së suksesshme të studimeve, ata tashmë kontribuojnë në institucionet e Republikës së



Kosovës, ku do të punojnë për së paku tri vjet si nëpunës civilë në kuadër të administratës publike", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Kontributi i tyre shtrihet në Zyrën e

Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e

Drejtësisë, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministrinë e Shëndetësisë.



# Pyjet e Kosovës përballen me shkatërrim të pakontrolluar

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Qysh i vogël Faruk Foniqi e ka karakterizuar dashuria për natyrën. Jashtë shtëpisë së tij në fshatin Dobërçan të Gjilanit atë e tërhiqnin pyjet përreth dhe lumi që kalon përmes fshatit. Por, gjatë fëmijërisë së Foniqit vendlindja e tij filloi të pësonte ndryshime. "Bash ku jemi ne, në ato prona bëhet prerje ilegale e drunjve", thotë 28-vjeçari për Radion Evropa e Lirë.

Prerja ilegale e drunjve vlerësohet si fenomeni kryesor që sjell humbjen e qindra hektarëve të tokës pyjore në Kosovë çdo vit. Mes viteve 2000 dhe 2022 Kosova humbi gati 16 mijë hektarë tokë pyje apo nga 2 deri në 3.5 hektarë në ditë, sipas një analize të bërë nga organizata Sustainability Leadership Kosova (SLK).

Foniqi, nga kjo organizatë, thotë se gjendja e pyjeve në Kosovë është alarmuese. "Kosova - me këtë trend të shfrytëzimit të pyjeve - llogaritet që, brenda dekadës së ardhshme, nuk do të ketë pyje të shëndetshme", thotë ai, duke treguar se për studimet e kësaj natyre, SLK-ja i dërgon të dhënat për verifikim edhe jashtë vendit.

Sipas tij, edhe pse prerjet e drunjve deri në një nivel janë të parapara, problemi në Kosovë është se prerja e tyre nuk monitorohet dhe nuk ka ndonjë plan revitalizimi të mirëfilltë të atyre zonave. "Në vendet e tjera parashihen masat dhe kush do ta menaxhojë hapësirën e shfrytëzuar pyjore dhe kush do ta ripyllëzojë atë hapësirë. E, fatkeqësisht, te ne nuk aplikohet ky sistem", thotë Foniqi.

SLK-ja, përveç raportimit për këtë fenomen dhe edukimit të të rinjve lidhur me problemet e mjedisit, në kuadër të programeve "Mos e merr malin" dhe "Green Wings" ka filluar edhe mbjelljen e hapësirave të shpyllëzuara.

Fillimisht, anëtarët e kësaj organizate përdorën dronë për të mbjellë fara drurësh në fshatin Butovc të Prishtinës, ndërsa thonë se do ta kenë edhe një tjetër projekt të tillë gjatë



vjeshtës së këtij viti.

Por, Foniqi insiston se ky problem do të zgjidhet shumë më shpejt nëse institucionet si Agjencia Pyjore e Kosovës, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), ndihmojnë në këto iniciativa. "Institucionet ndoshta hezitojnë të bashkëpunojnë në programe si 'Green Wings' për shkak se ne e publikojmë një statistikë të frikshme [për hektarët e tokës së shkatërruar pyjore]", thotë Foniqi, duke shtuar se në disa programe të tjera, megjithatë, ka pasur bashkëpunime.

MBPZHR-ja, duke iu përgjigjur REL-it, tregoi se Agjencia Pyjore e Kosovës i ka pyllëzuar mbi 140 hektarë gjatë vitit 2023, ndërsa këtë vit planifikohet pyllëzimi i 100 hektarëve me fidanët e prodhuar nga Instituti i Pylltarisë së Kosovës në Pejë.

Por, nga kjo ministri shprehën shqetësim lidhur me dënimet e shqiptuara, pasi që, siç thanë, "një nga faktorët që ndikon në zvogëlimin e kësaj dukurie, është edhe zbatimi i dënimeve të larta ndaj prerësve ilegalë nga ana e gjykatave". "Dënimet shpeshherë janë të vogla, krahasuar me dëmin që shkaktohet në pyje, pasi që dihet se një dru i prerë ilegalisht, për

t'u zëvendësuar me tjetrin nevojiten dhjetëra vite, duke shtuar këtu edhe aspektet tjera të dëmit", thonë nga MBPZHR-ja dhe shtojnë se duhet të ketë dënime më të ashpra veçanërisht për recedivistët.

Sipas të dhënave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, vetëm rreth 10-15 për qind e tokës pyjore në vend pritet sipas legjislacionit në fuqi.

Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që kapet duke prerë trungje të drunjve në pyje mund të dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet - varësisht nga sasia e drunjve të prerë.

Policia e Kosovës bëri të ditur për REL-in se gjatë tetë muajve të parë të këtij viti janë kapur 137 persona duke kryer veprën penale të vjedhjes së pyjeve. REL-i analizoi një pjesë të aktgjykimeve të shpallura nga gjykatat themelore të Kosovës gjatë këtij viti për rastet e vjedhjes së pyjeve.

Nga gjithsej 13 raste të analizuara, 11 prej tyre ishin dënime me gjobë nga 200 deri në 500 euro. Me 400 euro ishte dënuar Sh. Z. në Gjilan, pasi kishte prerë 33.4 metra kub drunj, duke shkakuar dëm prej 4.511 eurosh.

Me po të njëjtën vlerë ishte dënuar edhe J. B. në Prizren,

edhe pse ai kishte shkakuar dëm më të ulët, të vlerësuar 546 euro. Ndërsa, me 450 euro ishte dënuar M. K. në Ferizaj, pasi kishte shkakuar dëm prej 290 eurosh.

Gzim Shala, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë se shqiptimi i "dënimeve shabllon" është njëri ndër problemet me gjykatat në vend. "Ka një tendencë të një përcaktimi të disa dënimeve dhe arsytimit shabllon për disa fusha të caktuara, pavarësisht që secili rast i ka specifikat e veta", thotë ai për REL-in.

Në një nga rastet e analizuara nga REL-i, kryesi i veprës penale ishte lëshuar me vetëm vërejtje gjyqësore, pasi i ishte marrë si rrethanë lehtësuese "gjendja e dobët ekonomike". Shala nga IKD-ja tregon se Gjykata Supreme parashihet vlerësimin e rrethanave lehtësuese, por shton se gjykatat në Kosovë shpeshherë gabojnë në aplikimin e rrethanave lehtësuese dhe u japin më shumë rëndësi atyre lehtësuese sesa rënduese.

Për më tepër, ai thotë se edhe në disa fusha të tjera, si dhuna në familje apo armëmbajtja pa leje, shqiptimi i dënimeve të ulëta shkakton kryerjen e vazhdueshme të këtyre veprave penale. "Nuk themi që dënimet

duhet të jenë të larta në secilin rast, por dënimet duhet të jenë adekuate, aktgjykimet duhet të jenë të arsyetuar dhe t'u përgjigjen qëllimeve të dënimeve, që janë parandalimi i kryesit dhe dërgimi i mesazhit të shoqëria që t'ia ketë frikën ligjit dhe të mos përfshihet në vepra penale", thotë Shala.

Sipas të dhënave të marra nga raporti vjetor i monitorimit të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, gjatë vitit 2023, Departamenti Qendror i Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti i ka zhvilluar 702 kontrole dhe i ka sekuestruar 22.7 metra kub masë drunore.

Gjatë kësaj periudhe kohore, MBPZHR-ja ka pranuar 143 aktgjykime për rastet e prerjeve ilegale në pyjet shtetërore. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre rasteve ishin parashkruar pasi lëndët ishin vjetruar.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se shumica e pyjeve në vend janë nën pronësi shtetërore. Por, shkak i shkatërrimit të tokës pyjore, në mesin e llojeve të pyjeve, kjo agjenci liston edhe një kategori për pyje të degraduara.

Sipas studimeve të SLK-së, degradimi i pyjeve është në nivele më të larta veçanërisht në zonat kufitare të Kosovës, ku monitorimi i pyjeve është më i vogël.

Foniqi, nga kjo organizatë, thotë se, më parë, trungjet e prera të drunjve shiteshin për ngrohje. Por, pas subvencionimit të pajisjeve për ngrohje nga Qeveria e Kosovës, ai thotë se druri përdoret më shumë për industri të ndryshme.

Teksa ndër vite ka parë shkatërrimin e pyjeve në shumë zona të Kosovës, ai shpreson që gjeneratat e reja në vend do të jenë më të vetëdijshme për rëndësinë e pyjeve. "Pyjet nuk janë vetëm një resurs që mund ta shfrytëzojmë për nevojat tona, por janë edhe resurs për gjeneratat që vijnë pas nesh dhe, njëkohësisht, kujdesen edhe për ajrin e pastër në vendin tonë", përfundon Foniqi.

## Më 2 dhe 3 tetor në Berlin, Kosova merr pjesë në Festivalin Global të Gastronomisë

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se pjesëmarrja e Kosovës në Festivalin Global të Gastronomisë Shqiptare, më 2 dhe 3 tetor në Berlin, është një ngjarje e veçantë për bizneset tona kreative, kulturën dhe traditën tonë shqiptare. "Nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve

në Kosovë, kemi mbështetur organizimin e kësaj ngjarje ekspozuese të gastronomisë shqiptare, me një shumë prej 108 000 eurosh, duke mundësuar kështu pjesëmarrjen e më shumë se 50 bizneseve tona, me promovimin e kulturës, trashëgimisë dhe traditës sonë shqiptare në gastronomi dhe duke përcjell kështu, kudo në botë, vlerat e mikpritjes së kombit tonë shqiptar, të trashëguara ndër

shekuj. Angazhimi dhe përkushtimi i qeverisë sonë do të vazhdojë duke mbështetur ndërmarrjet tona në rritje, çdo ditë e më shumë, me një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve me vlerë, për tregun vendor dhe ndërkombëtar. Prandaj, na ndajnë vetëm dy ditë për t'u takuar dhe bashkëbiseduar rreth potencialit ekonomik dhe investimeve në Kosovë", ka thënë Hajdari.





# Pse Izraeli dërgoi trupa në Liban?

Izraeli thotë se synon të gjymtojë forcat e Hezbollahut në një zonë të Libanit jugor, që grupi i armatosur kontrollon dhe ku ka ndërtuar tunele drejt Izraelit.

Izraeli dhe Hezbollahu kanë luftuar më parë – më së fundi në vitin 2006 – një konflikt njëmuor që përfundoi me një rezolutë të Kombeve të Bashkuara për armëpushimin, e cila u bënte thirrje të dyja palëve të tërhiqeshin nga një zonë tampon 20 milje në Libanin jugor, përgjatë kufirit verior të Izraelit.

Por Hezbollahu nuk u tërhoq kurrë nga rajoni dhe trupat izraelite hynë në zonë të hënën vonë në atë që ushtria izraelite e quajti një operacion “të kufizuar”. Ja pse Izraeli thotë se ka dërguar forca tokësore në Liban:

## Cili është qëllimi i Izraelit?

Pushtimi, të cilin ushtria izraelite e konfirmoi herët të martën, synon të gjymtojë forcat dhe infrastrukturën e Hezbollahut në një zonë të Libanit jugor që kontrollon grupi i armatosur, dhe ku dihet se ka ndërtuar tunele nëntokësore që të çojnë në Izrael. Inkursioni vjen pas dy javësh sulmesh ajrore intensive izraelite dhe atentatet me eksplozivë në pager-a dhe radiomarrëse, kundër grupit të armatosur libanez të mbështetur nga Irani. Zyrtarët izraelitë thanë se sulmet kishin pjesërisht për qëllim të eliminonin udhëheqjen e grupit; një sulm ajror të premtën vrau liderin e Hezbollahut, Hassan Nasrallah.



## Pse Izraeli po vë në shënjestër Libanin jugor?

Libani jugor është një zonë e thyer, e mbushur me lugina të pjerrëta në të cilat ata që mbrohen mund t'i zënë pritë kollaj një ushtrie pushtuese, një faktor që mund të ketë formësuar planifikimin ushtarak izraelit. Terreni i ashpër ka ndihmuar historikisht fraksionet në rajon të mbrohen dhe Hezbollahu e ka përdorur gjeografinë në avantazhin e vet, në luftërat e kaluara me Izraelin. Udhëheqësit ushtarakë izraelitë kryen disa muaj stërvitje përgatitore për trupat që mund të dërgoheshin për të luftuar në

rajon.

## Çfarë është Rezoluta 1701 e OKB?

Rezoluta 1701 e Kombeve të Bashkuara, e cila i dha fund luftës së vitit 2006, u bëri thirrje trupave izraelite të tërhiqen nga Libani jugor në një zonë në Kodrat e Golanit, nën atë që njihet si Linja Blu dhe Hezbollahut të tërhiqej në veri të lumit Litani, rreth 20 milje nga kufiri verior i Izraelit. Zona në mes, ku ishte zhvilluar pjesa më e madhe e luftimeve mes tyre, do të bëhej një zonë tampon. Rezoluta kërkon që zona të kontrollohet nga ushtria

libaneze dhe forcat paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara. Një forcë paqeruajtëse e OKB-së ka mbetur në zonë, por rezoluta nuk u zbatua kurrë plotësisht. Hezbollahu ka argumentuar se prania e tij në zonën tampon është e justifikuar sepse Izraeli ende mban të pushtuar tokën libaneze.

Megjithëse OKB-ja mendoi se Izraeli ishte tërhequr plotësisht nga Libani në vitin 2000, Izraeli mbeti në një zonë të njohur si Fermat Shabaa, të cilën OKB-ja e konsideron një pjesë të pushtuar të Sirisë. Libani dhe Hezbollahu thonë se toka është libaneze. Rezoluta kishte parashikuar çmilitarizimin e Hezbollahut,

por grupi ka fituar vetëm fuqi politike dhe ushtarake.


Në vitin 2008, Izraeli kërkoi bisedime paqeje me qeverinë e Libanit, por u refuzua, kryesisht për shkak se Hezbollahu kishte fituar pushtetin politik në një marrëveshje me qeverinë libaneze. Izraeli pohon se Hezbollahu ka ndërtuar arsenalin e tij të raketave që synojnë kufirin verior të Izraelit dhe ka ndërtuar më shumë tunele nëntokësore, që do t'i lejonin grupit të depërtonte dhe të sulmonte Izraelin, siç bëri në vitin 2006.

Në vitin 2018, një operacion ushtarak izraelit zbuloi tunele të ndërtuara nga Hezbollahu, duke e shtyrë Izraelin të bëjë thirrje për veprim ndërkombëtar. Forcat e OKB-së në Liban konfirmuan praninë e tuneleve. Muajin e kaluar, ndërsa Izraeli shtoi sulmet ajrore ndaj Hezbollahut, ministri i jashtëm i Izraelit, Israel Katz, i dërgoi një letër Kombeve të Bashkuara duke argumentuar se ushtria izraelite synonte të pengonte planet e grupit të armatosur, për të depërtuar në Izrael dhe bëri thirrje për zbatimin e Rezolutës 1701.

Hezbollahu ka pësuar goditje të rënda përtej humbjes së liderit të tij në sulmet e intensifikuara izraelite që i paraprinë pushtimit, duke përfshirë sulme të rënda ajrore pranë dhe në Bejrut gjatë fundjavës. Por Hezbollahu ka vazhduar të lëshojë raketa në veri të Izraelit – dhe herë pas here në Izraelin qendror – duke dëshmuar qëndrueshmërinë e tij. Sipas ekspertëve, Hezbollahu mendohet se ka ndoshta arsenalin më të madh të çdo grupi të armatosur në botë, duke përjashtuar qeveritë.







# Sonte nëntë ndeshjet e tjera në Ligën e Kampionëve, vëmendja në sfidën Leipzig - Juventus

“Epoka e re”

**LEIPZIG, 1 TETOR** - Nëntë ndeshjet e tjera të rrethit të dytë në Ligën e Kampionëve zhvillohen sonte (e mërkurë). Dy ndeshje zhvillohen nga ora 18:45, shtatë të tjera zhvillohen nga ora 21:00. Ndeshja më interesante e kësaj nate pritet të jetë ajo në mes të RB Leipzig dhe Juventusit. Pas humbjes me një gol të vonshëm në ndeshjen hapëse, RB Leipzig do ta synojë fitoren e parë të sezonit në Ligën e Kampionëve, kur Juventusit i pamposhtur do ta vizitojë të mërkurën në mbrëmje.

Skuadra e Bundesligës u mposht në fund të ndeshjes nga Atletico Madridi (2-1), kurse “Zonja e Vjetër” triumfoi ndaj kampionit holandez PSV Eindhoven (3-1). Mirëpo, Leipzigu së fundmi e mposhti Augsburgun me rezultat bindës 4-0 dhe tash është më motiv maksimal për ndeshjen e dytë në garën më të fortë në futboll.



Ylli i Leipzigit, Benjamin Sesko, është i bindur se mund t'i hapin probleme Juventusit: “Çdo ndeshje jep motivim, por Juventusit dhe futbollit italian në përgjithësi janë të famshëm për soliditet në mbrojtje. Bardhezinjtë janë të fortë në këtë drejtim, por edhe të paparashikueshëm në sulm. Megjithatë, ne i kemi idetë e qarta dhe e dimë se çfarë duhet të bëjmë për t'i dëmtuar”. Juventusit po tregon formë të mirë, pas fitores ndaj PSV-së luajti baras me

Napolin dhe në fundjavë e mposhti Genoa (3-1). Ndërsa kampioni në fuqi i kësaj gare, Real Madrid, do të ketë punë me skuadrën e Edon Zhegrovës, Lille. Favorit pritet të jetë edhe Bayern Munchen që do të luajë në Angli ndaj Aston Villës, kurse më lehtë pritet ta ketë skuadra e Juventusit që do të përballet me Bolognan. Arber Hoxha dhe Arian Ademi me Dinamo Zagrebin do të presin Monacon, kurse Berat Gjimeshi me Atalantën i shkon Shakhtar Donetskut.

## TË MËRKURËN TAKOHEN:

**18:45 Girona - Feyenoord**  
**18:45 Shakhtar Donetsk - Atalanta**  
**21:00 Aston Villa - Bayern Munchen**  
**21:00 Benfica - Atletico Madrid**  
**21:00 Dinamo Zagreb - Monaco**  
**21:00 Lille - Real Madrid**  
**21:00 Liverpool - Bologna**  
**21:00 Leipzig - Juventus**  
**21:00 Sturm Graz - Club Brugge**

# Edmond Azemi, koordinator i përgjithshëm i programit afatgjatë FBK - MKRS 2024-2029

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Edmond Azemi është emëruar koordinator i përgjithshëm i Programit Afatgjatë FBK - MKRS 2024-2029. Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka miratuar emërimin e legjendës së basketbollit në këtë pozitë. “Bazuar në kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht Neni 23, si dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Bordit të FBK-së, më 01.10.2024, pas shqyrtimit të propozimit nga komisioni për intervista, Bordi i FBK-së miraton emërimin e ish-basketbollistit Edmond Azemi në pozitën e koordinatorit të përgjithshëm të programit afatgjatë FBK - MKRS 2024-2029. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij”, thuhet në vendim. Edmond Azemi është basketbollisti më i trofeshëm në vendin tonë me Prishtinën, derisa ka qenë edhe pjesë e Kosovës A, ku për shumë vjet ka dhënë maksimumin për “Dardanët”.



## SHKURT

### Rashica dhe Aliti, në formacionin e javës në Turqi

Rashica dhe Aliti janë përfshirë në formacionin e javës së shtatë në Superligën turke. Dy përfaqësuesit nga Kosova bënë paraqitje të shkëlqyeshme me ekipet përkatëse në ligën elitare të futbollit turk. Futbollisti vushtrias shkëlqeu me një asistim dhe një penallti të nxjerrë te Beshiktashi në fitoren e pastër ndaj Kayserisporit me rezultat 3-0. E veçanta e krejt kësaj ishte se Rashica në këtë ndeshje luajti si mbrojtës i djathtë. Për të ky ishte asistimi i tretë sezonal, ndërsa e ka realizuar edhe një gol. Mbetet të shihet nëse ish-futbollisti i Werder Bremenit, Norwich Cityt e Galatasarayt do të aktivizohet si mbrojtës i krahut edhe në vazhdim të sezonit. Kurse Aliti, një titullar i padiskutueshëm tek Alanyaspori, ishte i pakalueshëm në fitoren minimale 1-0 ndaj Rizesporit. Formacioni: Gunok, Lima, Aliti, Opoku, Rashica, Ntcham, Fernandez, Dimitrov, Puskas, Romulo, Banza.

### UEFA ua beson drejtësinë gjyqtarëve të Kosovës në ndeshjen Santa Coloma - Kalev

Gjyqtarët nga Kosova po vazhdojnë ta marrin besimin e UEFA-s për ta ndarë drejtësinë në ndeshjet evropiane. Shtëpia më e madhe e futbollit evropian, UEFA, delegon Mervan Bejtullahun gjyqtar kryesor që ta ndajë drejtësinë në ndeshjen FC Santa Coloma dhe FC Kalev në kuadër të UEFA Youth League. Në ndeshjen e cila do të zhvillohet në stadiumin “Centred’Entrenament FAF” në Andorrë, gjyqtarin Bejtullahun do ta asistojnë Alban Ejupi dhe Meriton Berisha. Kjo ndeshje do të zhvillohet të enjten më 3 tetor me fillim nga ora 19:30.

### Kosova mëson orarin e ndeshjeve të Kampionatit Botëror në eSports

Pasi kemi mësuar kundërshtarët e Grupit A, ku Kosova bën pjesë në këtë sezon të eFIBA, tashmë kemi mësuar edhe orarin e ndeshjeve të fazës parakualifikuese. Më 8 tetor fillojmë rrugëtimin tonë në Kampionatin Botëror të eSports Basketball kundër Zvicrës. Të njëjtën ditë Kosova do të ndeshet edhe me Greqinë dhe Francën, nënkampionen botërore të sezonit 2. Më 10 tetor Kosova zhvillon ndeshjet kundër Britanisë së Madhe, Italisë dhe e mbyllim këtë fazë me ndeshjen kundër Suedisë. Ekipi i Kosovës po vazhdon përgatitjet për të pasur paraqitje sa më dinjitoze në pjesëmarrjen e parë në kualifikimet për Kampionatin Botëror eFIBA. Pesë nga shtatë ekipet e grupit kalojnë në fazën tjetër. Federata e Esports e Kosovës është partnere e FBK-së në këtë projekt. “Për kanalet online se ku mund t'i ndiqni këto ndeshje, do t'ju njoftojmë me kohë”, ka njoftuar FBK-ja.



## Hamiltoni dhe depresioni: Kam vuajtur që në fëmijëri, s'kisha me kë të flisja

LONDËR, 1 TETOR - Lewis Hamiltoni nuk është tipi i njeriut që fsheh vështirësitë e tij. Në shumë vite të Formulës 1, shtatë herë kampioni i botës ka zbuluar disa nga dobësitë e tij: marrëdhënien fillimisht problematike me babanë e tij Entoni, dyshimet për vlerën e tij dhe pasojat

psikologjike pas humbjes së shumëpërfolur në Botërorin 2021. Së fundmi, në një intervistë me gazetën britanike "Sunday Times", piloti i Mercedesit, i cili do të bashkohet me Ferrarin sezonin e ardhshëm, rrëfeu se kishte pasur një pengesë tjetër gjatë jetës së tij: depresionin. Hamiltoni pranon se

ai ndihej veçanërisht i brishtë gjatë adoleshencës së tij dhe sezoneve para se të mbërrinte në Formula 1: "Gjatë gjithë jetës sime jam marrë me shëndetin tim mendor. Kam vuajtur nga depresioni në një moshë shumë të hershme, kur isha rreth 13 vjeç. Mendoj se është diktuar nga

presioni i garave dhe problemet në shkollë, si bullizmi", rrëfen Hamiltoni. Një shqetësim i përqendruar nga vështirësia për të gjetur dikë të përshtatshëm për ta dëgjuar: "Nuk kisha asnjë me kë të flisja për këtë". As takimi me një psikolog nuk e kishte ndihmuar ta menaxhonte mirë këtë fazë,



ndonëse Luisi e komenton kështu këtë pjesë: "Nuk kishte qenë shumë e dobishme, por do të më pëlqente ta provoja sot".

## Ronaldo: Nuk më ka mbetur shumë kohë, po e shijoj çdo çast

RIYADH, 1 TETOR - Cristiano Ronaldo ishte prapë protagonist në fitoren e Al-Nassrit ndaj Al-Rayyanit me rezultat 2-1 në AFC Champions League. Ylli portugez e realizoi një gol mjaft të bukur me të majtën në minutën e 76 për t'ia siguruar fitoren ekipit saudit. Me këtë rast, 39-vjeçari arriti në kuotën e 71 golave, ndërsa i ka bërë edhe 17 asistime me klubin nga Pro Saudi League. Përkundër moshës së shtyrë, portugezi nuk ka shfaqur shenja lodhjeje apo rënie të formës fizike apo teknike. Ai i realizoi 50 gola me ekipin nga Arabia Saudite në vitin e kaluar, ndërsa synon të vazhdojë të shënojë gola të tjerë, ndonëse e pranon se nuk i ka mbetur shumë kohë e gjatë për të luajtur futboll. Goli i mbrëmshëm i Ronaldos ishte special pasi atë ia dedikoi babait të tij të ndjerë, i cili kishte ndërruar jetë në vitin 2005. "Ne e bëmë një paraqitje të shkëlqyeshme, krijuam shumë raste. Goli i sotëm ka shije tjetër. Do të doja që babai im të jetë gjallë sepse sot është ditëlindja e tij", ka thënë ish-futbollisti i Sporting Lisbonës, Manchester Unitedit, Real Madridit dhe Juventusit. Ronaldo e shënoi golin e 904-t në karrierë dhe ai nuk e ka fshehur dëshirën për ta arritur numrin jubilar prej 1 000 golash në karrierë.



CR7 ka kontratë me Al-Nassrin deri në vitin 2025, por palët po negociojnë që ajo të vazhdohet edhe për një vit. Synim tjetër i Ronaldos është që të luajë në Kupën e Botës 2026 me Portugalinë dhe pas saj, me gjasë, të pensionohet nga futbollit. "Unë ende kam dëshirë të luaj futboll dhe e di se nuk më ka mbetur shumë kohë në fushën e blertë. Gjëja më e rëndësishme është të mos konsiderohesh lojtari më i mirë apo të fitosh trofe gjithsesi. Gjëja më e rëndësishme është që ta shijosh këtë sport dhe të jesh i përdorshëm dhe i dobishëm për klubin dhe për Kombëtaren.

Rekordet janë pjesë e imja dhe jam mësuar t'i thyej ato. E kam ndier presionin që nga dita e parë dhe mendoj se do ta ndiej deri në ditën e fundit", ka përfunduar Ronaldo. Ajo që e bën më madhështor këtë superlojtar është se portugezi ka shënuar më shumë gola pas moshës 30-vjeçare sesa para saj. Në fakt, para se t'i mbushte 30 vjet, Ronaldo i kishte realizuar 440 gola në 596 ndeshje zyrtare. E pas të 30-tave, CR7 i ka shënuar 441 gola, pra një më shumë, në 523 ndeshje zyrtare. Pra, Ronaldo po tregohet si vera e kuqe, sa më i vjetër, aq më i mirë.

### SHKURT

#### Asani shënon përsëri në Ligën e Kampionëve të Azisë

Jasir Asani vazhdon të shkëlqejë në Ligën e Kampionëve të Azisë, duke qenë tani një nga emrat më të spikatur të këtij turneu. Sulmuesi i Kombëtares shqiptare, pasi shënoi 3 gola në ndeshjen e parë historike të Guangjusi në këtë turne, ka gjetur edhe sot rrugën e rrjetës. Në ndeshjen ndaj japonezëve të Kavasakit frontale në transfertë, Asani i dha avantazhin Guangjusi në minutën e 21-të të takimit. Ai transformoi me saktësi një penallti, duke çuar sferën në rrjetë për të kaluar para skuadrën e tij në një sfidë ndaj një prej ekipeve me traditë ndërkombëtare që luan rregullisht në këtë turne. Për Asanin ky ishte goli i katërt në Ligën e Kampionëve të Azisë, duke u bërë menjëherë golashënuesi më i mirë i këtij edicioni dhe duke tërhequr vëmendjen e klubeve më të mëdha jo vetëm në Azi, por edhe në Evropë, ku ai pret të kthehet vitin e ardhshëm.

#### Iniesta paralajmëron tërheqjen nga futbollit

Legjenda e Spanjës dhe Barcelonës, Andres Iniesta, mund të deklarojë shumë shpejt tërheqjen nga futbollit i luajtur. Është e përditshmja britanike "The Sun" që ka publikuar lajmin se me shumë gjasë në 8 tetor do të vijë edhe zyrtarizimi i tërheqjes së Iniestës nga futbollit. Sipas "The Sun", ka qenë vetë Iniesta që ka postuar një video, duke pikturuar një murale të portretit të tij dhe në fund të saj kishte shkruar datën 8 tetor, duke paralajmëruar tërheqjen nga bota e futbollit. Kujtojmë që Iniesta numëron 131 ndeshje si kapiten i Spanjës, me të cilën ka fituar Kupën e Botës më 2010 si dhe dy kampionate evropiane (2008 dhe 2012). Ndërkohë ai ka zhvilluar 674 ndeshje me fanellën e Barcelonës, duke shënuar 57 gola dhe fituar 37 trofe.

#### City synon ta 'blindojë' me kontratë afatgjatë Edersonin

Skuadra e Manchester Cityt ka nisur punën për ta rinovuar kontratën e portierit brazilian Ederson. Kontrata aktuale skadon në verën e vitit 2026, por po punohet për ta shtyrë atë edhe për një vit, deri më 2027. Ederson, 31-vjeçar, luan që prej vitit 2017 me "citizens" dhe në total numëron 340 ndeshje zyrtare me këtë fanellë. Ai mbetet një nga të besuarit e trajnerit Pep Guardiola, me të cilin ka fituar gjithçka me Manchester Cityn. Për momentin palët janë ende në bisedime, por rinovimi i kontratës do të thotë që ai do të luajë për kampionët e Anglisë deri në moshën 34-vjeçare. Një portier që asnjëherë nuk ka zhgënjyer, duke u kthyer në idhull të tifozëve.

#### Unitedi i jep një tjetër shans Ten Hagit

Erik Ten Hag do të ketë edhe dy ndeshje në dispozicion për të shpëtuar nga shkarkimi nga Manchester Unitedi. Presioni ndaj strategut anglez është shtuar ndjeshëm pas një fillimi të dobët të sezonit 2024-2025. Humbja e fundit në shtëpi 0-3 ndaj Tottenhamit është shoqëruar nga polemika të shumta nga tifozët, pasi Unitedi gjendet në vendin e 12-të në tabelë. Duetet kundër Portos dhe Aston Villas do të jenë vendimtare për fatin e Ten Hagenit. Unitedi do të luajë pa dy lojtarë të rëndësishëm Bruno Fernandes dhe Kobbie Mainoo.

## Shtatë kandidatë në garë për ta zëvendësuar Bach

LOZANË, 1 TETOR - Presidenti aktual i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, ka konfirmuar largimin nga detyra muajt në vijim. Ai e bëri këtë deklaratë gjatë Olimpiadës së Parisit, duke u larguar pas dy mandateve (që prej vitit 2013). Pas këtij vendimi është çelur edhe gara për kreun e ri të olimpizmit botëror, ku deri më tani janë zyrtarizuar shtatë kandidatë. Ata janë britaniku Sebastian Coe, spanjollli Juan Antonio Samaranch Jr, francezi David Lappartient, Kirsty Coventry i Zimbabve, japonezi Morinari Watanabe, suedezi Johani Eliasch dhe Princi Feisalal Husein i Jordanisë. Një garë e fortë, pasi bëhet fjalë për



kampionë në sport, ndërkohë që në garë është edhe një femër. Coventry, shtatë herë fituese e medaljes së artë në not, synon të bëhet gruaja dhe afrikana e parë që kryeson IOC. Presidenti i ri i IOC-së do të zgjidhet në një seancë në Olimpiadën e lashtë (18-21

mars 2025) dhe do të marrë detyrën në qershor të verës së ardhshme. Kandidatët do të bëjnë prezantime për anëtarësimin e plotë të IOC në një takim privat në Lozanë, Zvicër, në janar. Të gjithë presidentët e IOC kanë qenë burra, me tetë nga nëntë nga Evropa dhe një nga Shtetet e Bashkuara. Edhe britaniku Lordi Coe shihet si kandidat i fortë. Aktualisht ai drejton Federatën Ndërkombëtare të Atletikës (IAAF). Sipas rregullave aktuale të IOC, Coe nuk do të jetë në gjendje të shërbejë mandatin e parë të plotë tetëvjeçar, pasi ai arrin kufirin e moshës 70 vjeç të IOC më 2026. Gjithsesi, ai hoqi kufizime të ngjashme për t'u bërë president i Atletikës Botërore.

## Neymari rikthehet në stërvitje një vit pas lëndimit

Pas gati një viti nga dëmtimi i rëndë në gjurin e majtë, sulmuesi brazilian Neymar është rikthyer në stërvitje me skuadrën e Al Hilalit. Ish-sulmuesi i Barcelonës dhe PSG-së ka kryer seancën e parë


stërvitore me grupin. Gjithsesi, faza e rikuperimit 100 % nga dëmtimi vijon ende dhe tani do të vijojë të stërvitet me topin para se të rikthehet në ndeshjet zyrtare. "Jam rikthyer. Jam i lumtur që jam sërish me

grupin. Dhe tani vetëm gëzim", ka shkruar Neymar. Vitin e fundit janë bërë virale lotët e tij gjatë periudhës së rehabilitimit, por ky kalvar i gjatë tashmë ka marrë fund. Neymari kishte luajtur vetëm 5

ndeshje të kampionatit të kaluar dhe më pas erdhi dëmtimi i meniskut dhe të ligamentit të kryqëzuar në tetor 2023. Pavarësisht rikthimit në grup, për ta parë Neymarin në fushë duhet prituri janari. Për

shkak të dëmtimit të gjatë që pësoi, klubi që drejtohet nga trajneri Jorge Jesus nuk e ka federuar ende lojtarin për këtë sezon të Saudi Pro League. Kjo gjë mund të ndodhë vetëm në janar.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina  
GJIMNAZI "EQREM ÇABEJ" NË PRISHTINË

Gjimnazi "EQREM ÇABEJ" në Prishtinë

Nr. i protokollit 711

Më 01.10.2024

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016 (MASHT) për aktivitetet jashtëshkollore, Gjimnazi "EQREM ÇABEJ" shpallë këtë:

### FTESË PËR OFERTË

Gjimnazi "EQREM ÇABEJ" në Prishtinë organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2024-2025 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

#### I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës, më 01.10.2024 deri, më 07.10.2024;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcjellëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë; Datat e përcaktuara (Pesë ditë mes datave 08.10.2024 deri më 15.10.2024).
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë njëqind e gjashtëdhjetë (160), përfshirë edhe personelin e shkollës;
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

#### II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë përkujdesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës.
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për 160 nxënës dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në një dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;
21. Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

#### III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit të OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim (verifikohet nga Komisioni)
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mosshërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi të tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

#### IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 01.10.2024 deri më datën 07.10.2024;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në zarf të mbyllur në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara; Të noterizuara duhet të jenë dokumentet me nr. rendor një (1), dy (2), katër (4), dhe gjashtë (6).
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Prishtinë, më 01.10.2024



DREJTOR  
Shemsedin Beqiri

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kreshnik Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V sh.f.m.u. "Bajram Curi" Krushe e Madhe.

- Haxhi Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. "Lekë Dukagjini" Prizren, "Berat Gjonovci" Prizren.

- Valon Kerleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Arti Maka nga Juniku shpall të pavlefshme testin e maturës dëftesën e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.


- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina  
SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" Prishtinë



SHML "Medreseja Alauddin" Prishtinë  
Nr.prot: 476/24  
Datë: 02.10.2024

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, SHML "Medreseja Alauddin" shpallë këtë:

### FTESË PËR OFERTË

SHML "Medreseja Alauddin" në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2024/2025 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

#### I. Informata të përgjithshme

- Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt. 02.10.2024 deri më dt.08.10.2024;
- Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcelëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë;  
Datat e përcaktuara (Pesë ditë mes datave 14.10.2024 deri më 18.09.2024).
- Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
- Numri i nxënësve/eve maturantë/e që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë;
  - Djem tetëdhjetë e dy (82) përfshirë edhe personelin e shkollës;
  - Vajza nëntëdhjetë e tetë (98) përfshirë edhe personelin e shkollës;
- Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
- Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

#### II. Kushtet

- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron përkujdesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës.
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për tetëdhjetë e dy (82) nxënës (djem) dhe nëntëdhjetë e tetë (98) nxënëse(vajza) dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në dhomë;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;

- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;
- Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

#### III. Dokumentet e kërkuara

- Leja e punës së OE;
- Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
- Vërtetimi tatimor nga ATK;
- Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
- Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
- Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
- Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
- Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
- Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
- Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
- Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim(Verifikohet nga Komisioni)
- Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
- Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
- Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemin për numrin e nxënësve për dhomë;
- Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
- Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
- Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
- Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
- Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
- Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
- Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

#### IV. Dorëzimi i dokumenteve

- Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) dita nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 02.10.2024 deri më datën 08.10.2024;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në zarf të mbyllur në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara; Të noterizuara duhet të jenë dokumentet me numër rendor një (1), dy (2), katër (4), dhe gjashtë (6).
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pizzeria Piatto" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812194893 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Pizzeria Piatto" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812194893 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Pizzeria Piatto" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812194893 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

